NR. 17, KORRIK 2023 | Viti II

Revistë e përmuajshme (politike-diplomatike)

# ARGUMENTUM

news opinion analysis



# Ish- zv/kryeministri i Shqipërisë Arben Ahmetaj shpallet në kërkim ndërkombëtar

-101 vjet nga vendosja e marrëdhënieve diplomatike Shqipëri-SHBA

- Shefi i OKB-së paraqet vizionin e ri për paqen në një "botë shumëpolare"

- SHBA-ja sanksionon shefin e inteligjencës së Serbisë, Aleksandar Vulin

Të dashur lexues dhe ndjekës të Argumentum.al,

**Argumentum.al** tashmë nga muaji prill 2022 vjen në versionin e një reviste të përmuajshme politike-diplomatike të cilën mund ta shfletoni online.
Ky botim mujor ofron një kombinim të qartë të lajmeve në vend, rajon dhe botë, si dhe opinioneve dhe analizave për ngjarjet e zhvilluara përgjatë një muaji.
Duke falënderuar secilin prej jush për vëmendjen dhe besimin ndaj medias tonë, ju premtojmë që do të vijojmë të sjellim për ju analizat objektive mbi zhvillimet kryesore në Vend, Rajon, Europë dhe në Botë.
**Argumentum.al** përpiqet të jetë burim autoritar i gazetarisë me analiza dhe komente mbi marrëdhëniet ndërkombëtare, politikën botërore dhe një gamë të gjerë çështjesh me rëndësi globale duke sjelle materiale ekskluzive. Kjo falë edhe kontributit të disa prej emrave të njohur të politikës dhe publicistikës shqiptare dhe bashkëpuntorëve të tjerë vendas dhe të huaj. Në të njëjtën kohë Argumentum.al është e hapur për komente e mendime të lexueseve të saj.
Lexoni falas mbi çështjet e brendshme dhe ndërkombëtare në revisten Argumentum.al në shqip dhe anglisht!

**“Argumentum”, një proces intelektual …**

**Marjana DODA**
**Kryeredaktore**

# Përmbajtja


**03 JO VETEM LAJM**
- SPAK shpall në kërkim ndërkombëtar zv. kryeministrin Arben Ahmetajn!
- 28 KORRIK 1923 - 28 KORRIK 2023 / Shtetet e Bashkuara dhe Shqipëria shënojnë 101-vjetorin e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike.
- Bill Clinton në Tiranë: Po shoh të ardhmen në një vend ku e shkuara mund ta kishte vrarë!
*Tensionet në Kosovë, Clinton: Ta ndalim këtë marrëzi”*
- Kremlini njofton përfundimin e marrëveshjes së grurit

**11 POLITIKË**
- Kryeministri Rama: Ballkani i Hapur e kreu misionin, para kemi Procesin e Berlinit.

**12 FOKUS**
- Shefi i OKB-së paraqet vizionin e ri për paqen në një “botë shumëpolare”.
- Forumi Ekonomik dhe Humanitar Rusi-Afrikë/ Putin u premton kombeve afrikane grurë falas.
- Kinë-ASEAN ripohojnë angazhimin për të avancuar partneritetin strategjik gjithëpërfshirës

**18 REALPOLITIK**
- Mbyllet Ballkani i Hapur! Tur i dështuar! Kurti ka të drejtë por jo fuqi! Dilema ukrainiane e NATO-s!

**21 RAJONI**
- SHBA-ja sanksionon shefin e inteligjencës së Serbisë, Aleksandar Vulin.

***ENGLISH EDITION***
**23 ENGLISH TOP NEWS**
- Former Deputy Prime Minister Ahmetaj is declared internationally wanted.
- Assembly approves “cannabis” and the condition for medical students.
- President Begaj meets his counterpart Aliyev in Azerbaijan expressing, the wish for growth of Azeri investments in energy and tourism.
**28 REALPOLITIK**
- Open Balkans closed! A failed tour! Right is might! The NATO Ukrainian dilema!

# SPAK shpall në kërkim ndërkombëtar zv. kryeministrin Arben Ahmetajn!




Prokuroria e Posaçme Antikorrupsion (SPAK) ka shpallur në kërkim ndërkombëtar Arben Ahmetajn, ish-zv.kryeministër dhe Ministër i Financave i qeverisë Rama.

Interpoli dhe institucionet e tjera ligjzbatuese ndërkombëtare janë njoftuar. Ndaj ish zv.kryeministrit, SPAK ka ngritur akuzë për tre vepra penale. Ai akuzohet për korrupsion, fshehja apo mosdeklarim të pasurive dhe pastrim parash.

Kuvendi i Shqipërisë i hapi më 14 korrik 2023 rrugë arrestimit të ish-zëvendëskryeministrit Arben Ahmetaj.

Në seancën e posaçme plenare, 117 deputetë votuan pro kërkesës së SPAK për arrestimin e Ahmetajt, duke i hequr kështu imunitetin e deputetit.

> “Dumani në shkresë kërkon që mbledhja e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin të zhvillohet me dyer të mbyllura për të ruajtur sekretin hetimor, duke qenë se hetimet vazhdojnë në drejtim edhe të fakteve të tjera penale apo personave të tjerë të implikuar.

**Kronologjia nga kerke`sa e SPAK për arrestimin e ish -zv. kryeministrit Ahmetaj, deri te shpallja në kerkim ndërkombëtar më 24 korrik 2023.**

Prokuroria e Posaçme Antikorrupsion,SPAK dorëzoi me 10 korrik në Kuvendin e Shqipërisë kërkesën për arrestimin e ish-ministrit të Financave, Arben Ahmetaj.

Dumani në shkresë kërkon që mbledhja e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin të zhvillohet me dyer të mbyllura për të ruajtur sekretin hetimor, duke qenë se hetimet vazhdojnë në drejtim edhe të fakteve të tjera penale apo personave të tjerë të implikuar.

Në një njoftim të SPAK thuhet se, “Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, ka regjistruar proçedimin penal Nr. 277/1 të vitit 2022 për veprat penale të “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”, “Korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”, “Korrupsioni aktiv i


..../(E.M./A.D.) Tiranë, më 07.07. 2023

Kërkesë për dhënien e autorizimit nga Kuvendi për arrestimin/heqjen e lirisë dhe ushtrimin e kontrollit personal/të banesës së deputetit

**Znj. Lindita NIKOLLA**
**KRYETARE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**
**KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**TIRANË**

...nj. Kryetare e Kuvendit!

...në nenin 73 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 288 të K.Pr.Penale, si ...ulloren e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, nenet 13 dhe 118, bashkëlidhur ju ...kërkesën për dhënien e autorizimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, për ...heqjen e lirisë dhe ushtrimin e kontrollit personal/të banesës së deputetit, në kuadrin ...it penal nr. 277/1 të vitit 2022 të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe ...rganizuar Tiranë.

... se hetimet në kuadrin e procedimit penal nr. 277/1 të vitit 2022 vazhdojnë në ...e të fakteve të tjera penale apo personave të tjerë të implikuar në ndodhjen e tyre, ...respektimin e kuadrit ligjor procedurial penal mbi ruajtjen e sekretit hetimor, bazuar ...3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kërkojmë që çdo procedurë që do të ..., në lidhje me këtë kërkesë, nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Këshilli për ...n, Mandatet dhe Imunitetin, të zhvillohet në seancë me dyer të mbyllura.

... në respektim të nenit 288 pika 2, të K.Pr.Penale, bashkalidhur gjeni kërkesën dhe ...e arsyetuar, të shoqëruar me provat përkatëse.

...lenderuar për bashkëpunimin!

funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë", "Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", parashikuar respektivisht nga nenet 257/a, 260, 245, 287 të Kodit Penal.

Mbështetur në nenin 73 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 288 të K. Pr. Penale, si dhe në Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, nenet 13 dhe 118, në kuadrin e procedimit penal të mësipërm, ka paraqitur kërkesën për dhënien e autorizimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, për arrestimin/heqjen e lirisë dhe ushtrimin e kontrollit personal dhe të banesës së deputetit: Arben Ahmetaj, i biri i Nevruz dhe i Ferdane, datëlindja 28.06.1969, lindur në Gjirokastër, me nr personal G90628061Q.

Ky shtetas, rezulton se ka marrë cilësinë e personit nën hetim, në kuadrin e procedimit penal nr. 277/1 të vitit 2022, pasi dyshohet se ka kryer veprat penale të: "Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim", vetëm dhe në bashkëpunim, në formën e deklarimit të rremë, dhe në formën e fshehjes, parashikuar nga neni 257/a paragrafi i dytë, neni 25 i K. Penal;

"Korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë" parashikuar nga neni 260 i K.Penal, 6 (gjashtë) herë;

"Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", në bashkëpunim, më shumë se një herë, parashikuar nga neni 287 paragrafi i dytë i Kodit Penal.

Që të ekzekutohet kjo kërkesë do duhet që të jepet leja nga Kuvendi, ndërsa pritet edhe mbledhja e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, që të shqyrtohet kërkesa për heqjen e mandatit të deputetit dhe më pas të kalohet në seancë plenare.

Për këtë më 12 Korrik, Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin miratoi kërkesën e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, për dhënie autorizimi nga Kuvendi për arrestim/heqjen e lirisë dhe ushtrimin e kontrollit personal/të banesës së deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, Arben Ahmetaj.

Në drejtimin e kryetares, Lindita Nikolla, Këshilli vazhdoi mbledhjen me të njëjtin rend dite si në mbledhjen e kaluar, me zhvillimin e dëgjesës me përfaqësuesit ligjor të deputetit, Arben Ahmetaj.

Ndërsa më 14 korrik, Kuvendi miratoi me 117 vota pro, asnjë kundër dhe 3 abstenim që t'i hiqet imuniteti deputetit Arben Ahmetaj dhe në këtë mënyrë autorizoi SPAK-un që ta arrestojë dhe të kontrollojë banesën e tij.

Në seancën e posaçme të zhvilluar sot në Kuvendin e Shqipërisë, ku u diskutua kërkesa e SPAK ishin të pranishëm 120 deputetë.

**Më 14 korrik, Kuvendi miratoi me 117 vota pro, asnjë kundër dhe 3 abstenim që t'i hiqet imuniteti deputetit Arben Ahmetaj dhe në këtë mënyrë autorizoi SPAK-un që ta arrestojë dhe të kontrollojë banesën e tij. Në seancën e posaçme të zhvilluar sot në Kuvendin e Shqipërisë, ku u diskutua kërkesa e SPAK ishin të pranishëm 120 deputetë.**

# Mesazhi i ish-Zëvendës kryeministrit para votimit në Kuvend




Pak minuta para se të niste seanca e posaçme në Kuvend për të lejuar arrestimin e tij nga SPAK, ish zv. Kryeministri Arben Ahmetaj, shkruan se çdo ditë do të bëjë gjithçka për të dalë e vërteta. Një mesazh të koduar kishte për kolegët e tij.

"Falënderoj kolegët e mi të mazhorancës dhe opozitës për nxitimin e treguar këtë javë. I "mirëkuptoj" për këtë, sepse politika dhe drejtësia e re e akoma e hershme për t'u quajtur e maturuar, kërkojnë statistika. Siç tha dhe avokati im "Populizmi gjyqësor e penal në ngjitje është më i rrezikshëm se sa populizmi politik, për shkak se humbet e i mungon legjitimiteti demokratik". Avokati im në Këshillin e Mandateve citoi një thënie të vjetër nga Franca: "E shoh që dy zgjidhje të mundshme ka në tavolinë, ose do të bjerë koka e mbretit, ose ju do të duhet të pranoni dështimin e revolucionit", shkruan Ahmetaj.
Ahmetaj akuzon për kërcënime dhe thotë se edhe të vetët në PS promovuan luftën kundër tij.
"E kam përjetuar diku me qetësi, diku me "buzëqeshje të brendshme", diku me revoltë të brendshme, nxitimin triumfues të largimit një vit më parë, totalisht një sinjal për "të gjitha kafshët e pyllit", kërcënimin me demek indirekt në një forum partie "se do ikja në të s'ëmës", habinë dhe thyerjen kur mora vesh se kush nga "tanët" promovuan mercenarët të shërbenin kundër meje, "marrjen peng" të bashkëjetueses time dhe ish-bashkëshortes time"
Ish ministri i Financave i cilëson absurde akuzat e SPAK për njohje me një person tjetër, se bashkëshortja e tij ka shitur një pronë të deklaruar, se bashkëjetuesja ka blerë një pronë në Hamallaj, se ka bërë alokime e rialokime ligjore, se ka bërë biznes, se nuk ka marrë pjesë në tendera dhe se është përdorur fondi rezerve për financim e inceneratorit të Elbasanit, që sipas tij është tërësisht ligjore.
"Dikush me tha " te duan ne burg vëlla. Kam mare kërcënime (I kam me screenshot e me zë ndoshta), madje se fundmi dhe një mesazh triumfi si mirëseardhje…Nëse do ta meritoj, sigurisht që do ndodhi…po jo përpara se e vërteta të marrë rrugë e dritë"
Teksa në fund i kërkon falje familjes për shqetësimet dhe e ka një premtim.
"Zoti e di të vërtetën, që unë do mundohem dit pas dite ta nxjerr…. To be continued"



Ish-Zëvendës kryeministri, Arben Ahmetaj

*"Falënderoj kolegët e mi të mazhorancës dhe opozitës për nxitimin e treguar këtë javë. I "mirëkuptoj" për këtë, sepse politika dhe drejtësia e re e akoma e hershme për t'u quajtur e maturuar, kërkojnë statistika. Siç tha dhe avokati im "Populizmi gjyqësor e penal në ngjitje është më i rrezikshëm se sa populizmi politik, për shkak se humbet e i mungon legjitimiteti demokratik". Avokati im në Këshillin e Mandateve citoi një thënie të vjetër nga Franca: "E shoh që dy zgjidhje të mundshme ka në tavolinë, ose do të bjerë koka e mbretit, ose ju do të duhet të pranoni dështimin e revolucionit"*

28 KORRIK 1923 - **28 KORRIK 2023**

# SHTETET E BASHKUARA DHE SHQIPËRIA

## shënojnë 101-vjetorin e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike



Në një mesazh publikuar në rrjetet sociale, ambasada amerikane theksoi se: "Sot është 101-vjetori i vendosjes zyrtare të marrëdhënieve diplomatike mes Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë. Lidhjet zyrtare diplomatike mes vendeve tona filluan më 28 korrik 1922, menjëherë pas përfundimit të Konferencës së Paqes në Paris, ku Presidenti i SHBA Wilson qëndroi në krah të popullit shqiptar për pavarësinë dhe sovranitetin e tij. Vitin e kaluar, me rastin e 100-vjetorit të marrëdhënieve diplomatike, ne festuam miqësinë e ngushtë mes dy kombeve tona, duke theksuar aleancën e fortë strategjike mes Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë. Presidenti i SHBA Joe Biden dërgoi një mesazh të veçantë shprese për bashkëpunim të vazhdueshëm dhe për një të ardhme edhe më të ndritshme për popullin shqiptar. Urojmë për më shumë vite të tjera miqësie dhe bashkëpunimi!".

Ambasada risolli edhe mesazhin e Presidentit amerikan, Joe Biden, drejtuar popullit shqiptar në vitin 2022, kur u shënua 100-vjetori i këtyre marrëdhënieve.

"Mbarë popullit shqiptar, i dërgoj urimet e mia më të përzemërta dhe miqësinë jetëgjatë të SHBA. Kur Shtetet e Bashkuara mbrojtën pavarësinë e Shqipërisë pas Luftës së Parë Botërore, u krijua një miqësi e përhershme midis popujve tanë. Një dashuri të përbashkët për lirinë dhe për vlerat e demokracisë, të cilat nuk u thyen kurrë dhe kur populli i Shqipërisë i qëndroi dekadave në diktaturë. Uroj që dy kombet tona të vazhdojnë të ndërtojnë mbi gjithçka që kemi arritur së bashku dhe të ofrojnë një të ardhme më të ndritshme dhe më shpresëdhënëse për fëmijët tanë", shprehej Biden në mesazhin e tij në atë kohë", thuhet në mesazhin e Ambasadës së SHBA-së.

Presidenti i Republikës, Bajram Begaj, ka uruar 101-vjetorin e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike mes Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Në një mesazh publikuar në rrjetet sociale, Begaj shprehet se SHBA ka qenë dhe do mbetet,






aleati me strategjik i Shqipërisë, në rrugën tonë euroatlantike.
"Në këtë 101-vjetor të vendosjes së marrëdhënieve diplomatike me Shtetet e Bashkuara, shohim me krenari se si këto marrëdhënie janë gjithnjë e më të forta! Përgjatë historisë, Shtetet e Bashkuara kanë qenë gjithmonë në krahun tonë, duke na mbështetur në të gjitha projektet dhe sukseset tona madhore, ndaj për këtë do i jemi përherë mirënjohës. Gëzuar 101-vjetorin e miqësisë me SHBA-në, partnerin strategjik më të madh të Shqipërisë dhe shqiptarëve", u shpreh Presidenti.
Kryeministri Edi Rama ka kujtuar sot 101-vjetorin e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike mes Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.
Në një status në facebook krahas fotot së dy flamujve të Shqipërisë dhe SHBA-së, Rama shprehet se dy vendet janë "miq dhe aleatë".

Marrëdhëniet diplomatike Shqipëri-SHBA kanë nisur më 28 korrik 1922, pak muaj pas përfundimit të Konferencës së Paqes në Paris, ku presidenti amerikan Uillson doli në krah të vendit tonë.

Ambasadori i parë amerikan në Tiranë ishte Ulysses Grant Smith, i cili e nisi misionin diplomatik më 4 dhjetor 1922.
Ambasadori i parë shqiptar në Uashington ishte Faik Konica, i cili u emërua në këtë detyrë në vitin 1929 nga Ahmet Zogu.
Më pas Ambasada amerikane në Tiranë u mbyll më 16 shtator 1939, ndërsa ngrirja e marrëdhënieve zgjati edhe gjatë kohës kur në pushtet erdhi Enver Hoxha.
Marrëdhëniet diplomatike midis Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë u rivendosën më 15 mars 1991, pas një ndërprerjeje prej 52 vjetësh. Ambasada e SHBA në Tiranë u hap më 1 tetor 1991, me Kristofer Hill si i Ngarkuar me Punë dhe i pasuar nga ambasadori i SHBA Uilliam Eduin Rajerson, i cili ia paraqiti kredencialet e tij qeverisë së Shqipërisë më 21 dhjetor 1991.
Në ceremoninë historike në vitin 1991 për nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit, i cili rivendoste marrëdhëniet diplomatike mes dy vendeve, Ndihmëssekretari i atëhershëm i Shtetit për Çështjet Evropiane dhe Kanadeze Rejmond G.H. Saitc, tha "marrëdhënia midis vendeve tona fillon me vitet e hershme të këtij shekulli, kur Presidenti [Udrou] Uillson i ofroi mbështetjen amerikane shtetit të ri shqiptar. Marrëdhënia nuk u harrua kurrë nga mijëra amerikanët me origjinë shqiptare… të cilët mbajtën kontaktet me atdheun e tyre gjatë gjithë këtyre viteve."
Më 11 qershor 1991, ish-Sekretari i Shtetit Xheims A. Bejker III ishte zyrtari i parë i nivelit të lartë i SHBA, që vizitonte Shqipërinë pas periudhës së gjatë të izolimit të vendit. Që nga ajo kohë, marrëdhëniet SHBA-Shqipëri kanë përparuar e janë rritur, dhe Shqipëria është bërë një nga aleatet më të palëkundura të Amerikës, sidomos në luftën globale kundër terrorizmit.

**Faik Konica | Ambasadori i parë shqiptar në Uashington**

**Ambasadori i parë shqiptar në Uashington ishte Faik Konica, i cili u emërua në këtë detyrë në vitin 1929 nga Ahmet Zogu. Më pas Ambasada amerikane në Tiranë u mbyll më 16 shtator 1939, ndërsa ngrirja e marrëdhënieve zgjati edhe gjatë kohës kur në pushtet erdhi Enver Hoxha.**

# BILL CLINTON NË TIRANË:
# Po shoh të ardhmen në një vend ku e shkuara mund ta kishte vrarë!

**_Tensionet në Kosovë, Clinton: Ta ndalim këtë marrëzi!_**



Presidenti i 42-të i SHBA-së, Bill Clinton deklaroi gjatë vizitës së tij në Tiranë më 3 korrik se, dikur Shqipëria ishte një derë e zymtë e mbyllur, ndërsa sot është një derë e hapur.

Në fjalën e tij në ceremoninë e nderimit me "Kordonin e Madh me Yll të Mirënjohjes Publike" nga kryeministri Edi Rama, Clinton u shpreh se, "për mua kjo nuk është thjesht një ditë, kur kryeministri dhe populli i dhanë një njeriu, i cili nuk është më i ri dhe nuk ka më pushtet politik, një lëvdatë për atë çka shumë kohë më parë bëri në mënyrë të drejtë për ju. Kjo është dita kur rikonfirmohet koncepti se njerëzit që bëhen bashkë, përtej dasive të tyre, marrin vendime më të mira. Njerëzit, të cilët ngulen dhe rrinë vetëm me një grup. Grupet marrin vendime më të mira edhe se gjenitë e vetëm dhe kjo është diçka që mund të vërtetohet. Ajo çka kam shumë për zemër tashmë është që nipërit e mi të kenë një të ardhme më të shkëlqyer, që gjërat bëhen bashkë në vend që të përçahen dhe ju ma keni bërë të qartë se jeni dakord me këtë".

"Unë i dëgjova ata fëmijë dhe më lanë pa fjalë. Mos harroni. Nuk është për herë e lehtë. Mos harroni. Do të bëni gabime. Mos harroni. Dikush do të thotë diçka për ju që është e rreme, e pavërtetë dhe që nuk duhet ta thonë. Duhet të gjeni mënyrën sesi t'i përgjigjeni asaj", tha Clinton.

"Dua t'ju kërkoj që të vazhdoni kështu. Na duhen modele dhe ndonjëherë është e lehtë që vendet, të cilat kanë popullsi më të vogla dhe për rrjedhojë mund t'i shohin njerëzit, si njerëz e jo si personazhe vizatimorë dy dimensional, të udhëheqin rrugën për ne".

Clinton tregoi historinë e një kamerieri shqiptar nga Kosova, i cili në një restorant në Nju-Jork e kishte takuar dhe i kishte thënë se "falë teje familja ime është sot gjallë".

Nga Tirana presidenti i 42 i SHBA-së i çoi mesazh Prishtinës, që t'i japë fund tensioneve në veri. Clinton tha se ishte gabim që qeveria e Kosovës zhvilloi zgjedhje e theksoi se situata mund

të krijojë përplasje.
"Ka një mosmarrëveshje që po ndodh tani në Kosovë që do të doja të mos kishte ndodhur kurrë. Nuk është më vendimi im por kosovarët i krijuan ato katër qyteza në të mirë të serbëve për tu dhënë katër kryebashkiakë më tepër. Kështu që mendoj se kanë bërë një gabim që të votohej. Mendoj se është e lehtë për shqiptarët, tani në shumicë që të përpiqen që të përfitojnë nga momenti, për të paraqitur argumentin tyre, por gjëja e vërtetë që duhet të bëjmë është ta ndalim këtë marrëzi" tha Clinton.
"Vazhdoni kështu, mos i hidhni njerëzit poshtë kur ju zhgënjejnë. Rezistojini tundimit që njerëzit t'i trajtoni siç ju trajtojnë. Ju keni ndërtuar këtu diçka vërtetë të lavdishme. Bëni që gjithkush që vjen në Shqipëri, të shkojë në vendin e tyre me dëshirën që vendi i tyre të jetë më shumë si i juaji. Dikur ju ishit një derë e zymtë e mbyllur ndërkohë që tashmë jeni një derë e hapur", u shpreh Clinton.
Ai falënderoi qeverinë shqiptare që mikpriti afganët e larguar nga vendi i tyre.
"Faleminderit që morët drejtueset dhe gratë e OJQ-ve dhe i larguat nga shqetësimet e tmerrshme në Afganistan! Nuk e keni idenë sa e rëndësishme ishte kjo. Faleminderit për gjithçka keni bërë për të vërtetuar se ajo çfarë kemi të përbashkët është shumë më e rëndësishme sesa ndasitë tona dhe se dua të ndërtojmë një botë ku duhet të bëhemi bashkë! E gjithë pjesa tjetër është muzikë në sfond", tha Clinton.
"Kur vjen në moshën time, pyet veten se pse shpenzojnë njerëzit kaq energji që të shkatërrojnë të tjerët, për aq pak gjë. Ndodh shumë shpejt, jeta ikën, mbaron. Dhe gjithçka vlen nëse i ke lënë gjërat më mirë sesa i ke gjetur, nëse fëmijët kanë një të ardhme më të ndritur, nëse jeni bashkuar në vend që të ndaheni. Në këto kohëra kur jemi përballur me sfidën ekzistenciale që paraqet, klima, ndryshimi klimës për mënyrën tonë të jetesës. Kur u thua po këtyre gjërave gjithë gjërat e tjera nuk kanë vlerë", u shpreh ai.
"Sot më dhatë një dhuratë të madhe. Më të madhe madje edhe sesa nderi. Më latë të shohë çfarë bëhet për të ardhmen, në një vend ku e shkuara mund ta kishte vrarë. Vazhdoni kështu. Zoti ju bekoftë!", përfundoi fjalën e tij presidenti i 42-të i SHBA-së, Bill Clinton.



**"Vazhdoni kështu, mos i hidhni njerëzit poshtë kur ju zhgënjejnë. Rezistojini tundimit që njerëzit t'i trajtoni siç ju trajtojnë. Ju keni ndërtuar këtu diçka vërtetë të lavdishme. Bëni që gjithkush që vjen në Shqipëri, të shkojë në vendin e tyre me dëshirën që vendi i tyre të jetë më shumë si i juaji. Dikur ju ishit një derë e zymtë e mbyllur ndërkohë që tashmë jeni një derë e hapur".**

# Kremlini njofton përfundimin e marrëveshjes së grurit

> "Sapo të përmbushet pjesa ruse [e marrëveshjes], pala ruse do t'i kthehet menjëherë zbatimit të kësaj marrëveshjeje",




Marrëveshjet e Detit të Zi janë ndërprerë efektivisht të hënën – pjesa e marrëveshjes në lidhje me Rusinë nuk është përmbushur, tha zëdhënësi presidencial rus Dmitry Peskov para gazetarëve të hënën. "Marrëveshjet e Detit të Zi nuk janë më në fuqi. Afati, siç tha presidenti rus më herët, është 17 korriku. Fatkeqësisht, pjesa e marrëveshjes së Detit të Zi që ka të bëjë me Rusinë nuk është përmbushur ende. Si rezultat, është bërë përfundoi", tha ai, citon media ruse TASS.

"Sapo të përmbushet pjesa ruse [e marrëveshjes], pala ruse do t'i kthehet menjëherë zbatimit të kësaj marrëveshjeje", shtoi Peskov.

Ai gjithashtu vuri në dukje se qëndrimi i Rusisë për pezullimin e pjesëmarrjes së saj në marrëveshjen e grurit ishte shpallur përpara aktit më të fundit terrorist në Urën e Krimesë dhe ky sulm nuk ndikon në vendimin e Moskës.

Më 22 korrik 2022, në Stamboll u nënshkrua një paketë dokumentesh për furnizimin me ushqime dhe plehra në tregun ndërkombëtar. Marrëveshjet fillimisht u lidhën për një periudhë prej 120 ditësh. Ato u zgjatën për të njëjtën periudhë nëntorin e kaluar. Më 18 mars 2023, Rusia njoftoi zgjatjen e marrëveshjes për 60 ditë. Marrëveshja e grurit u zgjat edhe për dy muaj të tjerë më 18 maj.

# Kryeministri Rama: Ballkani i Hapur e kreu misionin, para kemi Procesin e Berlinit




Kryeministri Edi Rama tha të shtunën se thellimi i "Procesit të Berlinit" është një domosdoshmëri dhe një mundësi historike për Ballkanin Perëndimor në kushtet kur BE është gati të mbështesë një plan të ri financiar dhe ekonomik në rajon.

Në të njëjtën kohë, Rama shpalli fundin e "Ballkanit të Hapur", që sipas tij në një intervistë televizive nga Ulqini, ishte një nismë e lindur nga nevoja për të shtyrë përpara "Procesin e Berlinit".dhe ka përmbushur misionin për të cilin ka lindur

Kryeministri tërhoqi vëmendjen për faktin se "në tetor, Shqipëria pret Samitin e Berlinit në Ballkan për herë të parë në Tiranë, që kur Angela Merkel e nisi procesin në vitin 2014".

Ai tha se "Ursula Von der Leyen në Bratislavë dha një mesazh të parë në lidhje me planin për rritjen e financimit, për rritjen e aksesit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në tregun e përbashkët europian duke rritur instrumentet ekonomike".

Ndërkohë kryeministri Rama tregoi se ka në plan të bëjë një turne në rajon për të takuar të gjithë kryeministrat dhe presidentët e vendeve të rajonit dhe për të biseduar për këtë proces, duke u kërkuar kohezion dhe bashkëpunim.

# Shefi i OKB-së paraqet vizionin e ri për paqen në një "botë shumëpolare"




**Sekretari i Përgjithshëm Antonio Guterres u tha kombeve të botës të enjten se periudha e pas Luftës së Ftohtë ka përfunduar dhe bota po shkon drejt një epoke të re shumëpolare të shënuar tashmë nga niveli më i lartë i tensioneve gjeopolitike dhe konkurrenca e fuqive të mëdha në dekada.**

> "Konfliktet janë bërë më komplekse, më vdekjeprurëse dhe më të vështira për t'i zgjidhur", tha ai. "Vitin e kaluar ishte numri më i lartë i vdekjeve nga konfliktet në pothuajse tre dekada".

Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Antonio Guterres, paraqiti të enjten propozimin e tij për t'u përballur me atë që e quajti një rend të ri botëror shumëpolar, të karakterizuar nga tensione gjeopolitike në rritje, konflikte dhe teknologji të reja.

"Kërcënimet e reja të ditëve të sotme ndaj paqes shtojnë kërkesat ndaj nesh", u tha zoti Guterres përfaqësuesve të vendeve anëtare të OKB-së.

Ai tha se rekomandimet e tij, të paraqitura në një dokument politikash të titulluar "Një Axhendë e Re për Paqen", kanë parasysh natyrën e ndërlidhur të shumë prej sfidave globale.

"Konfliktet janë bërë më komplekse, më vdekjeprurëse dhe më të vështira për t'i zgjidhur", tha ai. "Vitin e kaluar ishte numri më i lartë i vdekjeve nga konfliktet në pothuajse tre dekada".

Ai tha se sulmi i Rusisë në Ukrainë e ka bërë më të vështirë për të trajtuar shumë prej sfidave globale.

“Nëse çdo vend do të përmbushte detyrimet sipas Kartës së OKB-së, e drejta për paqen do të ishte e garantuar”, tha zoti Guterres. “Por, kur vendet i thyejnë ato zotime, ata krijojnë një botë pasigurie për secilin”.

### Objektivat e zhvillimit

Sekretari i përgjithshëm tha se një nga çelësat për trajtimin e problemeve që po përjeton planeti është përshpejtimi i punës për axhendën 2030 – një plan me objektiva globale zhvillimi. Ai vuri në dukje se parandalimi i konfliktit dhe zhvillimi i qëndrueshëm mbështesin njëri-tjetrin.

“Nuk është koinçidencë që vendet e prekura nga konflikti janë më larg objektivave për zhvillimin e qëndrueshëm”, tha ai.

Ai shprehu shqetësimin për luftën bërthamore, që është rishfaqur me luftën e Rusisë në Ukrainë, dhe bëri thirrje për eliminimin e armëve bërthamore në përgjithësi.

“Deri në eliminimin e plotë, vendet që kanë armë bërthamore duhet të zotohen se nuk do t’i përdorin kurrë”, tha zoti Guterres.

Ai u bëri thirrje vendeve të pakësojnë shpenzimet ushtarake dhe të ndalojnë armët çnjerëzore dhe ato që shkaktojnë dëme në masë.

### Teknologjitë e reja

Drejtuesi i OKB-së shprehu gjithashtu shqetësimin për teknologjitë e reja që ofrojnë potencial për progres të madh, por që gjithashtu në rastin e inteligjencës artificiale dhe të armëve autonome (të njohura ndryshe si “robotët vrasës”), janë “duke krijuar mënyra të reja me të cilat njerëzimi mund të eliminojë vetveten”.



Në këtë front, zoti Guterres tha se komuniteti ndërkombëtar duhet të miratojë deri në vitin 2026, një instrument ligjor që do të ndalonte armë të tilla autonome. Ai mbështet gjithashtu idenë e krijimit të një entiteti të ri global për të shmangur rreziqet ndaj paqes dhe sigurisë nga inteligjenca artificiale. Ai e parafytyron këtë entitet me strukturë dhe mandat të ngjashëm me Agjencinë e Energjisë Bërthamore, e cila u krijua nga OKB-ja.

Sekretari i përgjithshëm tha se planifikon të krijojë një grup këshillimor të nivelit të lartë për të paraqitur opsionet në lidhje me qeverisjen e inteligjencës artificiale, i cili do të paraqesë raportin e tij brenda këtij viti.

Ndër rekomandimet e tjera, zoti Guterres bën thirrje për përfshirjen e grave në udhëheqje dhe vendimmarrje, duke vendosur kuota aty ku do të jetë e nevojshme.

Ai bën thirrje gjithashtu për një “reflektim të gjerë” mbi të ardhmen e operacioneve të paqeruajtjes së OKB-së. OKB-ja shpenzon miliarda çdo vit për misionet e saj paqeruajtëse, por me sukses të pakët. Dy nga misionet e saj më të mëdha – në Mali dhe në Republikën Demokratike të Kongos – janë duke u zvogëluar me kërkesën e vetë këtyre vendeve.

Zoti Guterres u bëri thirrje vendeve anëtare të OKB-së që të angazhohen në diskutimet për propozimet e tij. Në vitin 2024, Kombet e Bashkuara po planifikojnë organizimin e një Takimi të Nivelit të Lartë për të Ardhmen, që do të trajtojë rreziqet e ardhshme dhe mundësitë. Sekretari i përgjithshëm u tha vendeve anëtare se shpreson që rekomandimet e tij do t’i ndihmojnë në procesin e diskutimit dhe shqyrtimit.

## FORUMI EKONOMIK DHE HUMANITAR RUSI-AFRIKË

# Putin u premton kombeve afrikane grurë falas




> *“Rusia pranoi të marrë pjesë në të ashtuquajturën marrëveshje, duke marrë parasysh angazhimet që përmbante se pengesat e paligjshme për eksportin e drithit dhe plehrave tona në tregjet globale do të hiqen.”*

Presidenti rus Vladimir Putin të enjten u ofroi grurë falas gjashtë vendeve të varfra afrikane teksa nisi një samit me liderët nga kontinenti disa ditë pas tërheqjes nga marrëveshja e eksportit të grurit në Ukrainë.

Rusia është e gatshme të furnizojë grurë falas për një numër vendesh afrikane veçanërisht në nevojë në muajt e ardhshëm dhe mund të veprojë si një zëvendësim për Ukrainën në dërgimin e ushqimit në Afrikë në përgjithësi, tha Presidenti rus Vladimir Putin në seancën plenare të Forumit Ekonomik dhe Humanitar Rusi-Afrikë që po mbahet në Shën Petersburg , raporton media ruse TASS.

Sipas tij, Rusia është “sinqerisht e interesuar për thellimin e mëtejshëm të tregtisë, investimeve dhe lidhjeve humanitare” me kontinentin afrikan. Kreu i shtetit premtoi të rrisë kuotat për studentët afrikanë në universitetet ruse dhe u bëri thirrje vendeve të kontinentit që të kalojnë në mënyrë më aktive në shlyerjet në monedhat kombëtare.

Ja disa nga deklaratat kryesore të Putinit.

### Marrëveshja e grurit

Asnjë nga kushtet e Rusisë në marrëveshjen e grurit nuk është përmbushur. “Rusia pranoi të marrë pjesë në të ashtuquajturën marrëveshje, duke marrë parasysh angazhimet që përmbante se pengesat e paligjshme për eksportin e drithit dhe plehrave tona në tregjet globale do të hiqen.” “Në fakt, asgjë” nga ajo që u diskutua apo u premtua Moskës nuk ka ndodhur.

Një arsye tjetër për pjesëmarrjen e Rusisë në marrëveshje ishte dëshira për të siguruar ushqim dhe plehra për vendet në nevojë. Por në pothuajse një vit, marrëveshja e grurit ka parë gjithsej 32.8 milionë tonë mallra të eksportuara nga Ukraina, më shumë se 70% e të cilave shkuan

në vendet me të ardhura të larta dhe të mesme, veçanërisht në Bashkimin Evropian. Në të njëjtën kohë, Etiopia, Sudani, Somalia dhe një numër vendesh të tjera përbënin më pak se 3% të vëllimit të përgjithshëm, që është më pak se 1 milion ton.
Rusia është në gjendje të zëvendësojë grurin ukrainas si në bazë komerciale ashtu edhe në formën e ndihmës falas për vendet më në nevojë në Afrikë. Sidomos pasi ne presim një tjetër korrje rekord këtë vit.



**Furnizimet me grurë falas**

Rusia është e gatshme të dërgojë 25,000-50,000 tonë drithë pa pagesë në gjashtë vende afrikane në tre deri në katër muajt e ardhshëm. Këto vende janë Burkina Faso, Zimbabve, Mali, Somalia, Republika e Afrikës Qendrore dhe Eritrea. "Ne gjithashtu do t'i dorëzojmë këto produkte tek konsumatorët pa pagesë.

**Për pengesat e bashkëpunimit**

Rusia ka rënë dakord të furnizojë pa pagesë vendet afrikane me plehra ruse, të bllokuara në portet evropiane. Por "vetëm dy tufa të vogla nga 262,000 tonë plehra të tillë arritën të dërgoheshin: 20,000 tonë në Malavi dhe 34,000 tonë në Kenia", edhe pse ishte një "aksion thjesht humanitar".
"Po shfaqet një tablo paradoksale: nga njëra anë, vendet perëndimore po pengojnë furnizimin me drithë dhe plehra dhe nga ana tjetër, do ta them drejtpërdrejt, po na fajësojnë me hipokrizi për situatën aktuale të krizës në ushqimin global. treg", tha presidenti.
Afrika është në gjendje të prodhojë ushqim për t'u ushqyer vetë. Dhe Rusia është "e gatshme të ndajë ekspertizën e saj në prodhimin bujqësor me vendet afrikane dhe të ofrojë ndihmë në prezantimin e teknologjive më të avancuara".

**Për industrinë dhe tregtinë**

Thellimi i bashkëpunimit industrial Rusi-Afrikë është veçanërisht i rëndësishëm. Produktet industriale ruse, duke përfshirë automobilat dhe pajisjet e ndërtimit, janë gjerësisht të njohura dhe të kërkuara në kontinent. "Më shumë se 50% e furnizimeve ruse në Afrikë janë makineri, pajisje, produkte kimike dhe ushqim."
Në të ardhmen e afërt, Rusia pret të nisë një zonë industriale ruse në rajonin e Kanalit të Suezit të Egjiptit: ndërtimi i objekteve të para të prodhimit do të fillojë atje që në fillim të këtij viti, dhe në të ardhmen mallrat e prodhuara atje do të eksportohen në të gjithë Afrikën.
Korridori Ndërkombëtar i Transportit Veri-Jug do të bëjë të mundur dërgimin me efikasitet të mallrave ruse në Afrikë. "Natyrisht, ky korridor mund të përdoret edhe në drejtim të kundërt – për të furnizuar mallrat afrikane në tregun rus".
"Për zgjerimin e mëtejshëm të të gjithë gamës së lidhjeve tregtare dhe ekonomike, është e rëndësishme që të zhvendosen më fuqishëm shlyerjet financiare për transaksionet tregtare në monedhat kombëtare, duke

*Rusia ka rënë dakord të furnizojë pa pagesë vendet afrikane me plehra ruse, të bllokuara në portet evropiane. Por "vetëm dy tufa të vogla nga 262,000 tonë plehra të tillë arritën të dërgoheshin: 20,000 tonë në Malavi dhe 34,000 tonë në Kenia", edhe pse ishte një "aksion thjesht humanitar".*

përfshirë rublën." Moska është e gatshme të punojë me vendet afrikane për zhvillimin e infrastrukturës së tyre financiare, për lidhjen e institucioneve bankare me sistemin e mesazheve financiare që është krijuar në Rusi, i cili lejon kryerjen e pagesave ndërkufitare pavarësisht nga sistemet perëndimore që ekzistojnë aktualisht dhe vendos kufizime.

### Mbi energjinë

Më shumë se 30 projekte premtuese energjetike me pjesëmarrjen e Rusisë në 16 vende afrikane janë tani në faza të ndryshme zhvillimi. Kapaciteti total i projekteve energjetike aktualisht në zhvillim është rreth 3.7 GW.

Eksportet ruse të naftës bruto, produkteve të naftës dhe gazit natyror të lëngshëm në Afrikë u rritën 2.6 herë gjatë dy viteve të fundit.

Rosatom po ndërton termocentralin bërthamor El Dabaa në Egjipt. "Korporata shtetërore mund t'u sigurojë vendeve afrikane ekspertizën e saj unike dhe teknologjitë unike globalisht në fushën e përdorimit joenergjetik të atomit paqësor, për shembull, në mjekësi dhe <…> bujqësi."

### Për trajnimin e burimeve njerëzore

Tani pothuajse 35,000 studentë nga Afrika po studiojnë në universitetet ruse, "dhe ky numër po rritet çdo vit". "Kuota për arsimimin e afrikanëve në kurriz të buxhetit federal është rritur me dy herë e gjysmë në tre vjet dhe për vitin e ardhshëm akademik do të arrijë në më shumë se 4700 persona".

Rusia planifikon të hapë degë të



universiteteve kryesore ruse në Afrikë. "Bashkëpunim i ngushtë me institucionet arsimore afrikane do të vendoset gjithashtu në kuadrin e Universitetit të Rrjetit Ruso-Afrikan."

Moska propozon të "eksplorohet mundësia e krijimit të shkollave në gjuhën ruse në vendet afrikane". "Zbatimi i projekteve të tilla në gjuhën ruse dhe futja e standardeve të larta arsimore të vendit tonë do të jetë themeli më i mirë për bashkëpunim të mëtejshëm reciprokisht të dobishëm dhe të barabartë."

### Në media

Rusia propozon "të punohet për

> *Tani pothuajse 35,000 studentë nga Afrika po studiojnë në universitetet ruse, "dhe ky numër po rritet çdo vit". "Kuota për arsimimin e afrikanëve në kurriz të buxhetit federal është rritur me dy herë e gjysmë në tre vjet dhe për vitin e ardhshëm akademik do të arrijë në më shumë se 4700 persona".*

krijimin e një hapësire të përbashkët informacioni në Rusi dhe Afrikë, brenda së cilës informacion objektiv dhe i paanshëm për zhvillimet në mbarë botën do të transmetohet për audiencën ruse dhe afrikane".

Po punohet për hapjen e zyrave të mediave kryesore ruse në Afrikë, duke përfshirë agjencinë e lajmeve TASS, Russia Today dhe televizionin RT, VGTRK dhe Rossiyskaya Gazeta.

Samiti dhe forumi i parë Rusi-Afrikë u mbajt në Soçi të Rusisë në vitin 2019, ku morën pjesë përfaqësues të të 54 vendeve të kontinentit, si dhe tetë integrime dhe organizata të mëdha afrikane. Në Soçi u nënshkruan rreth 92 marrëveshje me vlerë totale 1.004 trilion rubla. Deklarata e përbashkët e miratuar në samit përcaktoi synimet dhe objektivat e zhvillimit të mëtejshëm të bashkëpunimit në të gjitha fushat. Për më tepër, u përcaktua një mekanizëm i ri dialogu, Forumi i Partneritetit Rusi-Afrikë, me një samit që do të mbahet një herë në tre vjet, organi kryesor i tij. Presidenti rus Vladimir Putin pati takime dypalëshe me liderë të 16 vendeve në margjinat e forumit në Soçi.

# KINË-ASEAN

## ripohojnë angazhimin për të avancuar partneritetin strategjik gjithëpërfshirës




Kina dhe Shoqata e Kombeve të Azisë Juglindore (ASEAN) janë zotuar të avancojnë partneritetin e tyre gjithëpërfshirës strategjik në Takimin e Ministrave të Jashtëm Kinë-ASEAN (10+1) të mbajtur të enjten më 13 korrik.

